

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E
VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS PER SUBJEKTIN:
“LLAZO” SH.P.K



Subjekti: “Llazo” sh.p.k

Aktiviteti: “Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret”





Vendndodhja: Stan Karbunare, Lushnje, Fier.

Pergatiti materialin : “Eko-Studio-Projekt” sh.p.k



Tirane, 2023

PERMBAJTJA

-  Hyrje
-  Baza ligjore
-  Metodika e vleresimit te mjedisit
-  Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme.

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

Ndikimi → efekti i nje projekti qe ka ne mjedisin rrethues

Vleresimi → analiza qe i behet ketij projekti

Mjedis → elementet abiotike dhe biotike

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit. Mbrojtja e mjedisit, si nje sistem dinamik, duhet pare ne teresine e faktoreve natyror, dhe te veprimet njerezor qe ushtrohen mbi te. Ato kane nje efekt te fuqishem mbi kushtet e jeteses se popullsisë, dhe jane nje element baze per krijime te favorshme ekonomike.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedisore te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti "Llazo" sh.p.k me administrator Z. *Aldi Llazi* është regjistruar pranë QKB me NIPT **K24218401K** për ushtrimin e aktivitetit "Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret". Aktiviteti zhvillohet në Stan Karbunare, Lushnje, Fier.



Tabela e Koordinatave					
Nr	Y	X	NR	Y	X
1	4393522	4531815	16	4393440	4532303
2	4393504	4531817	17	4393445	4532296
3	4393494	4531816	18	4393469	4532296
4	4393490	4531818	19	4393487	4532286
5	4393457	4531818	20	4393518	4532244
6	4393445	4531822	21	4393438	4532176
7	4393420	4531852	22	4393513	4532035
8	4393413	4531867	23	4393464	4532010
9	4393410	4531896	24	4393458	4531902
10	4393404	4531961	25	4393481	4531856
11	4393378	4532182	26	4393530	4531847
12	4393381	4532218	27	4393533	4531838
13	4393407	4532308	28	4393531	4531819
14	4393422	4532328	29	4393528	4531816
15	4393437	4532338	Sip = 0.04 Km2		

a) **Pershkrimi i qellimit te propozuar**

Prodhimi realizuar nga shfrytezimi i ketij vendburimi ne kete zone kane si destinacion perdorimin e tij ne industrine e ndertimit te zones ne forme te gureve te prodhuar direkt nga karriera dhe te materialit te perpunuar e fraksionuar si rere, granil apo çakull te madhesive te ndryshme. Per kete arsye, ne varesi te tregut te studiuar dhe te pritshem, subjekti parashikon nje prodhim vjetor nga 20 000m³/vit.



Pakoja produktive per te cilen eshte kryer studimi perfaqesohet nga gelqerore dolomitike shtrestrashe kryesisht brekçioze me strukture me kristale te medha.

Karakteristikat cilësore të argjilave janë:

CaO 45.42%
MgO 1.86%

Fe ₂ O ₃	1.08%
Al ₂ O ₃	0.1-2.88%
SiO ₄	3.4-11%
SO ₃	0.1-0.2%
Mbetja e patreteshme	1.9-9.78%

Sistemet e shfrytezimit qe do te perdoren do te jene:

- **Sistemi i shfrytezimit i thjeshte pa transport. (Ne frontet e punes ku mjet transportues nuk futet)**
- **Sistemi i shfrytezimit me transport me perdorimin e automjeteve.**

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane marre parasysh keta faktore:

- *Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit.*
- *Menyra e shkriferimit te mineralit i cili mund te realizohet pa lende plasese*
- *Menyra e ngarkimit e transportit te sterililit.*
- *Tipi i mjeteve te transportit qe do te perdoren.*

* *Ngarkimi i sterililit do te behet me ekskavator me kapacitet kove 1.5 m³.*

* *Transporti i sterililit do te behet me automjete veteshkarkuese.*

Bazuar ne faktoret e mesiperm sistemi i shfrytezimit qe do te perdoret ne kete karriere do te jete kombinimi i te dy sistemeve te mesiperm me/pa transport me automjete dhe depozitim e sterililit ne stiva te brendshme ne afersi te karrieres. Sterilit qe do te dale nga punimet e zbulimit, do te ngarkohet ne automjete me anen e ekskavatorit dhe do te transportohet ne vend-depozitimet brenda kufinjve te karrieres.

Sistemi i shfrytezimit

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh faktoret e meposhtem:

- Kushtet tekniko-minerare te objektit;
- Menyra e ngarkimit, transportit dhe depozitim te sterililit , te zbulimit;
- Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit;
- Menyra e ngarkimit dhe transportit te gurit gelqeror ne brendesi te karrieres dhe jashte saj.
- Mjetet e ngarkimit dhe transportit qe parashikohen te perdoren ne zbulim dhe prodhim.
- Menyren e rrezimit dhe shkriferimi te mineralit me ane te cekicit pneumatik.
- Ngarkimi dhe zhvendosja e gurit gelqeror te shkriferuar ne sheshet e **nenshkalleva dhe shkalleve te shfrytezimit** ku parashikohet te behet me eskavator me kove te variushme 1.5-2 m³
- Transporti i sterililit te zbulimit dhe gurit gelqeror parashikohet te behet me kamiona 9-12 ton
- Sterilet e zbulimit do te depozitohen brenda kufijve te zones se shfrytezimit, ne afersi te impantit te fraksionit **duke rritur kuoten nga +47-48 deri ne +50**

Bazuar ne sa me siper, sistemi i shfrytezimit qe parashikohet te perdoret eshte i thjeshte me transport te sterililit ne distance deri 0.5 km, duke lejuar ne kete menyre depozitim e tij brenda karrieres. Sterilet e depozituar do te perdoren teresisht ne menyre sukseseive per mbulimine siperfaqes se shfrytezuat duke i paraprire rigjenerimit te mjedisit.

Elementet e sistemit te shfrytezimit

Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohen te perdoret do te jene:

- Lartesia e shkalles se karrieres parashikohet te jete maksimalisht **10m** ;
- Lartesia e nenshkalles do te jete e variushme ne varesi te kushteve te terenit dhe trashesise se pakos produktive. **Rekomandohen te perdoren 2-3 nenshkalle me lartesi 3-3.5 m**
- Gjeresia e sheshit te punes ne gjendje fillestare 15-20 m dhe ne gjendje perfundimtare sa gjeresia e nenshkalles apo shkalles te percaktuar nga konfiguracioni i terenit ;
- Kendi i skarpates te perkoheshme ne shkallet normale te punes ne shkembenj me çarje **70° -80°**;
- Kendi i skarpateste perkoheshme me perkulje konvekse (ne kryqezimin e karrieres me transhete e hyrjes ne te) dhe ne perkuljet konkave (ne cepat e karrieres), **60-70°** ;
- Ngarkimi dhe transporti i mekanizuar;
- Shkriferimi dhe zhvendosja e gurit gelqerorit parashikohet te jete me perdorimin e çekiçit rezues me dalte te sheshte.
- Zhvendosja e tyre brenda nenshkalles apo shkalles do te behet me ane te eskavatorit ose direkt me ngarkim ne mjet, dhe ne rastin e horizontit +100 ne Jug te zones minerare me hedhje ne shkallen e poshtme.

Shfrytezimi parashikon fillimin e punimeve nga lart-poshte. Kjo menyre lejon ne rradhe te pare zhvillimin e rregullt te punimeve, persa i perket shkalles se sigurise ne pune si dhe krijon mundesi per te punuar jo vetem ne nje shkalle por ne disa njekohesisht.

Elementet gjeometrik te sistemit te shfrytezimit

- | | |
|---|----------------------------------|
| ✓ Lartesia e shkalles ne karriere | 10m. |
| ✓ Kendi i skarpates se shkalles | 70-72. |
| ✓ Gjeresia e shesheve te sigurise | 2,5 - 3m |
| ✓ Ngarkimi dhe transporti | te mekanizuar. |
| ✓ Rrezimi i gurit gelqeror | Cekic. |
| ✓ Prodhimi ditor | 38 m ³ |
| ✓ Rendimenti per dite pune direkt ne prodhim | 35-45 m ³ /dite pune. |
| ✓ Rendimenti per dite pune/punonjes gjithsejt | 20-30m ³ /d.pune. |

Dimensionet ne shtrirje:

- | | |
|--|-------|
| ✓ Dimensioni i karrieres ne kuoten me te larte | 80 m |
| ✓ Dimensioni i karrieres ne kuoten me te ulet | 400 m |

Treguesit kryesore te sistemit te shfrytezimit

- | | |
|--|------------------------------|
| ✓ Thellesia e karrieres | 50 m |
| ✓ Numri i shkalleve | 5 |
| ✓ Gjeresia e shesheve te punes | 10-15 deri 30-35 |
| ✓ Horizonti i fundit | +50 m |
| ✓ Horizonti i siperm | +100 m |
| ✓ Drejtimi i shfrytezimit | nga J-P ne V-L |
| ✓ Rradha e shfrytezimit | nga lart-poshte /e kombinuar |
| ✓ Depozitimi i sterileve | brenda kufinjve te karrieres |
| ✓ Rrezja e kthimit te makinerive ne front eshte | 12 m |
| ✓ Gjeresia e shperndarjes se mases se rrezuar ne shkalle | 13,4 m |
| ✓ Gjeresia e brezit te sigurimit | 2,5~3 m |

✓ Gjerësia e sheshit të punës

33 m

Llogaritja e gjerësisë së sheshit të punës në shkallë:

$$A = B + X + C_1 + T + C_2 \text{ m}$$

ku:

X – gjerësia e materialit të rrezuar (m)

T - gjerësia e rrugëve të transportit (m)

C_2 - distanca e sigurisë nga vija e sipërme e shkallës së poshtme dhe vijës së rrugës së transportit (m).

C_1 - distanca e sigurisë nga vija e rrugës së transportit dhe materialit të rrezuar në shkallën e karrierës (m).

Gjerësia e materialit të rrezuar llogaritet:

$$X = B(K \text{ sh } x H/h') + \frac{H \sin(\alpha - \gamma)}{2 \sin \alpha \sin \gamma}$$

$$h' = (0,8 - 0,9)H = 0,8 \times 10\text{m} = 8 \text{ m}$$

$$X = 8.1 (1.4 \times 10/8) + \frac{10 \sin(65^\circ - 30^\circ)}{2 \sin 65^\circ - \sin 30^\circ} = 13.4 \text{ m}$$

Gjerësia e sheshit të punës të shkallës së karrierës rezulton:

$$A = 8.1 + 13.4 + 2.5 + 6 + 3 = 33 \text{ m}$$

Rradha e shfrytëzimit

Rradha e shfrytëzimit do të jetë nga lart-poshtë (horiz +100 drejt +50). Vetëm vitin e parë shoqërisë i rekomandohet të shfrytëzohet në horizontin +50 nga poshtë për faktin se është i lidhur me rrugë, krijon sheshin për vendosjen e impiantit të fraksionit, hap kanalet dhe gropat për mbjelljen e pemëve të cilat do të përdoren për barriera ndaj zhurmave, pluhurit etj.

Drejtimi i shfrytëzimit

Drejtimi i shfrytëzimit përgjithësisht do të jetë nga kufiri J-P në atë V-L. Shfrytëzimi në çdo horizont do të fillojë në gjysëm transhetë e shkurtra të çdo horizonti të cilat sic theksuam tek varianti i hapjes, ato do të fillojnë krahas ndertimit të rrugës. Transhetë do të hapen me gjysëm seksioni deri në kufinjtë perfundimtare të shtrirjes në zonën që shfrytëzohet.

Shfrytëzimi në vitin e parë do të fillojë në horizontin +50 në drejtim J-P, V-L dhe do të zhvillohet kryq-shtrirjes.. Me fillimin e shfrytëzimit nga lart-poshtë, shfrytëzimi mund të fillojë në dy ose tre horizonte njëkohësisht me konditë që balli i shkallës së sipërme të jetë jo më pak se 15m, me i avancuar se balli i shkallës së poshtme.

Lendet e para

Lenda e parë janë guret gelqerore që përftohen nga shfrytëzimi me karriere dhe lenda djegëse e makinerive

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Lushnja shtrihet në Shqipërinë P, në Uitësirën Perëndimore. Sipërfaqja 712 km². Popullsia 114.600 banorë. Përfshin një qytet Lushnjën, qendra e rrethit, 116 fshatra të grupuara në 21 fshatra të bashkuara. Dendësia mesatare 165.4 banorë/km², popullsia në qytet 20%, në fshat 80%. Rritja natyrore 2.1%. Mbizotëron relievi fushor, rreth 1/5 është kodrinore. Lartësia mesatare 67 m. Zona më e lartë, Mollasi, me majën më të lartë (299 m). Fushat shtrihen në P dhe përbëjnë pjesën kryesore të Myzeqesë së Madhe. Luginat kryesore: e Shkurnbinit dhe e Semanit. Lumenjtë: Shkumbini dhe Semani në rrjedhjen e poshtme derisa derdhen në Adriatik. Klima është mesdhetare fushore në nënzonën qendrore

Zona minerare për të cilat kerkohet leja ndodhet në bashkinë Lushnje. Në aspektin e relievit, në lindje të fshatit Satan Karbunarë ka terren kodrior me kuotën më të lartë 228m dhe pjesa tjetër është terren fushor të ndara midis tyre thuajse diagonalisht nga rruga nacionale Lushnjë-Fier dhe Lushnjë-Berat. Ka [ër[uthje midis gjeomorfologjisë dhe ndërtimit gjeologjik, sepse ajo pjesë kodrinore i përket ngritjes antiklinale të Lushnjës dhe pjesa fushore është e përfshirë tërësisht në sinklinalin e Lushnjës.

Zona fushore përfshin pothuajse gjithë sioërfaqen e bashkisë Lushnjë. Kjo zonë kap kuotat nga 20m në anën lindore e deri në 6-7m në pjesën perëndimore të aj, relievi i kësaj zonë është gati i rafshët.

Kalueshmëria në rajon është në përgjithësi e mirë me një rrjet rrugor të përhapur me një mirmbajtje relativisht të mirë. Komuniteti merret me bujqësi e blektori. Klima e rajonit është e tipit mesdhetar, gjysm kontinentale. Dimrat janë relativisht të butë e dekadat e fubdit po paraqiten me rreshje të pakta. Verat janë të nxehta e të thata.



Relievi

Terreni i bashkisë Lushnje është kryesisht fushor, me kodra që shkojnë deri në 200 m lartësi mbi nivelin e detit në zonën verilindore dhe në zonën e Kolonjës. Zona fushore ka lëvizje të lartësisë nga 2.5 deri në 52 m mbi nivelin e detit dhe njihet për prodhimtarinë e madhe bujqësore. Kjo zonë bën pjesë në fushën e Myzeqesë dhe njihet për numrin e madh të serrave dhe rrjetin e pasur me kanale vaditëse. Fusha e Muzeqesë është ndër fushat më të mëdha në Republikën e Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë ka edhe prodhimtarinë më të madhe. Emri i saj mendohet se vjen nga familja sundimtare e zonës, familja Muzakaj, e cila ka luajtur rol të rëndësishëm në historinë e vendit.



Klima.

Klima në këtë bashki, sipas klasifikimit Köppen-Geiger², i përket Csa3 dhe njihet në përgjithësi me termin klimë mesdhetare. Tiparet karakteristike të kësaj klime janë: dimër i butë me reshje dhe verë e ngrohtë e thatë. Prania e trupave ujorë në këtë bashki sjell edhe zbutjen e klimës gjatë verës, kur lagështia e ajrit mund të jetë më e lartë. Ky efekt është edhe më i dallueshëm në zonat urbane, ku prezenca e një trupi ujor (lumë, liqen etj.) mundëson krijimin e një mikroklimë me temperatura më të ulëta në krahasim me pjesën tjetër urbane. Bashkia Lushnje ka rreth 2,500-2,700 orë diell në vit⁴. Temperatura mesatare luhartet nga 15-16°C. Në përgjithësi, nuk ka erëra me shpejtësi të madhe. Zona lindore e Bashkisë ka erëra me shpejtësi 1.5-2.0 m/s, ndërsa pjesa perëndimore ka erëra më të shpejta të cilat arrijnë shpejtësinë 2.6-3.0 m/s. Pjesa qendrore e Bashkisë ka erëra me shpejtësi 2.1- 2.5 m/s⁵. Reshjet janë të çrregullta në këtë bashki dhe variojnë mesatarisht nga 750-1,250 mm⁶ në vit.

Bimesia

Bashkia e Lushnjes mbetet furnizuesi kryesor i vendit dhe i eksportit me produkte bujqësore. Me kategorinë e bujqësisë, mbizotëruese në përdorimin e tokës me 77 % të territorit të bashkisë, tokat bujqësore të Lushnjes karakterizohen nga cilësia e lartë e dheut dhe prodhueshmëria e lartë. Pavarsisht mungesës së një informacioni të saktë mbi kategorinë e tokës sipas klasës së bonitetit të tokave (sipërfaqet), në bashkinë Lushnjes mbizotërojnë tokat me bonitet të lartë të

kategorisë I-IV. Megjithatë, sipërfaqe të ndryshme të tokës në bashkinë Lushnje janë toka të kripura, moçalore ose aluvionale. Vetëm në fshatin Plug në Nja-në Golem, për shembull, sipërfaqja e tokave të kripura arrin në 12.17 ha. Kjo sipërfaqe do të ishte shumë herë më e madhe në rast se do të gjendeshin të dhënat rreth tokave të kripura në rang bashkie

Bimesia e objektit

Rajoni ku ndodhet vendi ku kerkohet leja e shfrytezimit eshte i zhveshur plotesisht nga bimesia. Bimesia, ne shume pjese te saj, eshte ende e pasur sidomos mbi depozitime flishore dhe mollasike. Ato perfaqesohen nga shkurre mesdhetare te cilet jane degraduar nga prerjet pa kriter. Shkurret me te perhapura jane mareja, shqopa, shkoza, menishtja, xina, perralli, mersina etj. Shkurret gjethe renese si : driza, lofata, murrizi etj. Por jane kultivuar pisha e bute dhe akacia si dhe ullinjet, rrushi dhe drure te ndryshem frutore. Bimesia ne siperfaqene zones se shfrytezimit kushtezohet nga mos prania e mbuleses, tokes vegjetale mbi gelqeroret litotamnike qe ndertojne *zonen minerare te hapur nr 289/6*. Ne zonen e dherave qe ne rastin tone eshte shume e vogel (mbuleses qe nuk perfaqeson rezerva gjeologjike) rriten lule dhe bar si dhe jane zhvilluar me se miri bime te kultivuara , pemishte frutore, ullinj dhe vreshta. Zona e shte e mirnjohur per kultivimin e vitikultures, oliuokultures dhe frutavete tjera te ndryshme Nje vend te rendesihem ze kultivimi ne sera i domateve , kastravecave dhe perimeve te tjera. Rilevimi i zonës që kërkohet me koordinatat përkatëse në plan, ndërtesat ekzistuese ose ndonjë objekt tjetër brenda zonës.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- **Ndikimet ne popullsi**

Ushtrimi i aktivitetit do te kryhet ne Stan Karbunare, Lushnje, Fier. Ne afersi te vendndodhjes se ketij aktiviteti ka zona te banuara, ku pika kyce e zhvillimit te ketij aktiviteti eshte mos shqetesimi i banoreve duke marre masa konkrete dhe efikase si dhe punesimi i banoreve perreth duke rritur keshtu nivelin ekonomik te ketyre familjeve qe ndodhen ne fshatin prane.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat qe krijohen jane si rezultat i makinerive qe perdoren per transport, zhurma te tjera nuk ka gjate zhvillimit te aktivitetit pasi ai nuk perdor lende plasese per shfrytezimin e gurit gelqeror. Duke qene se ne afersi te ketij aktiviteti ka zona te banuara, subjekti do marre masa konktete sic jane kontrolli i vazhdueshem i automjeteve te transportit ne karriere apo ndertimi i barrierave natyrore ne zonat ku ka afersi me shume me zonat e banuara.

- **Ndikime nga shkarkimi i ujerave**

Nga gjenerimi i ketij aktiviteti nuk ka shkarkime ne ujera.

- **Ndikimet ne toke**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk gjenerohen mbetje te ngurta te cilat te perbejne rrezik per ndotjen e tokes, te vetmet mbetje qe gjenerohen jane ato qe vijne nga aktiviteti personal i punonjesve te cilat shkojne ne vendet e caktuara nga pushteti lokal.

- **Ndikimet ne ajer**

Duke qene se kemi te bejme me nje aktivitet karriere , kemi nje gjenerim te pluhrave ne ajer por qe nuk shkaktojne ndotje te nje niveli shqetesues. Per ta evituar, here pas here subjekti ben sperkatje me uje te territorit.

- **Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare**

Nga zhvillimi i aktivitetit, ne zonen ku zhvillohet dhe territorin per rreth, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne brendesi te territorit te Republikes se Shqiperise, prandaj dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

- **Ndikimet ne perdorimin e tokes**

Aktiviteti ne fjale eshte i pajisur me nje leje minerare, dhe per kete arsye ne perfundim te shfrytezimit te kesaj siperfaqe toke, do beje rehabilitimin e saj. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative ne perdorimin e tokes, nuk do te perdoret siperfaqe tjeter toke pervec asaj te miratuar per kete qellim.

- **Ndikimet ne ekonomi**

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky aktivitet duke qene aktivitet i nxjerrjes se mineraleve te reres dhe argjiles sjell ndikime pozitive ne ekonomi duke rritur te ardhurat jo vetem te investitorit por duke punesuar edhe punonjes nga zona perreth rrit nivelin e tyre te jeteses. Mund te themi qe mineralet qe perftohen nga ky aktivitet mund te perdoren si lende te pare per procese te tjera ne sektorin e ndertimit dhe per kete arsye eshte nje aktivitet qe ka ndikime pozitive ne ekonomine e vendit tone.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Me qellim qe te parandalohen, shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marre masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

- **Mbrojtia e banorve nga ndikimet negative**

Vendburimi i gelqerorve litotamnike te Karbnuares, Lushnje eshte zbuluar qe prej vitit 1960 dhe ka vazhduar te shfrytezohet qe prej asaj kohe. Ne kete vendburim jane levizur me mjira meter kub mineral per prodhimin te vogel te gelqeres dhe cakell per mbushje. Pas vite 90 shume banor kane ndertuar banesat afer ketij objekti. Shoqeria eshte mire informuar mbi ndikimet negative qe mund te sjell ky projekt prane ketyre banorve. Per te mos krijuar shqetesime tek banoret do te investoj ne vitet e para te lejes ne ndertimin e barrierave. Masat qe do te marri shoqeria jane qe ne vitin e pare:

- ❖ Mbjelljen e pemeve 2-vjecare me distance cdo 1m pergjate gjithe perimetrit te lejes minerare
- ❖ Dherat e gjeneruara (top Soil) do te vendosen ne drejtim nga impianti i fraksionimit per te penguar perhapjen e zhurmave
- ❖ Nuk do te perdori lende plasese per shkrikerimin e mineralit
- ❖ Vibrimi i mjeteve nuk do ti kaloj PVV= 3mm/s
- ❖ Pluhuri i dukshem do te kufizohet vetem brenda perimetrit te zones se punes
- ❖ Kamionat me material do te jene te mbuluar
- ❖ Lagien e rrugeve te aksesit
- ❖ etj

Ne rast se do te kete ankesa nga banoret e zones shoqeria menjehere do te marre masa per te mos krijuar shqetesime ne jeten e tyre. Eshte per tu theksuar se transporti i mineralit nga vendi i germimit tek impanti thyerjes eshte i vogel pasi dhe vete prodhimtaria e parashikuar eshte ne vlera minimale. Transportuesit do te jene te mbuluar me kapak per te reduktuar emetime e pluhurit gjate transportit.



Pemët si barrierë për thyerjen e erërave ndaj objekteve sensitive



Barrierë me pemë për zhurmat dhe pluhurat

- **Mbetjet e ngurta**

Llogaritja e kapacitetit depozitues eshte bere per nje sasi jo te madhe rezervash per faktin se dhe prodhimi eshte ne nivele te uleta. Sheshi i depozitimit te minerali do te jete provizor dhe do te mbaj vetem mineralin e perpunuar per nje kohe te shkurter. Ai eshte caktuar ne Horizontin e fundit te karrieres kuota +50 m.

Sheshi i depozitimit të mbulesës është parashikuar në zone mes profileve P1 – P2, në Jug-te zonës minerare. Aktualisht aty ndodhet një humbje e sheshit e cila mendohet të mbushet me sterile. Në përfundim kjo sipërfaqe do të ketë kuotën e sheshit fundor. Sipërfaqja që do të zëri sheshi i depozitimit është 1850m² dhe i mjaftueshëm për rreth 11 000 m³ steril.

Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetësor i punëtorëve apo ambalazhet do të grumbullohen nëpër thasë të posaçshëm dhe do të transportohen drejt qendrave më të afërta të banuara për menaxhim nga sektoret përkatës të pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant të përdorur do t'u jepen subjekteve që merren me riciklimin e tyre dhe që aktualisht operojnë edhe në Shqipëri (Ministria e Mjedisit posedon një listë të subjekteve riciklues).

○ **Kushtet e punës**

Investitori ka krijuar kushte të favorshme pune për punonjësit e tij. Për të përbushur sigurinë e punëtorëve ofron kushte të mira pune, punëtorët janë të pajisur me uniforma. Stafit është me eksperiencë në këtë fushë. Janë marrë masa për sigurimin teknik dhe sistemin e ambienteve të punës.

Vlerësimi i efektivitetit të pritshëm të masave zbutëse

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës do të çojnë në sipërfaqe të pastra, të sistemuara e të gjelberuara.

5. KONKLUSIONE

❖ Konkluzione

- Zbatohen rregullat e sigurimit teknik. Punëtorët njihen me këto rregulla në mënyrë periodike nga drejtuesi teknik të firmës.
- Mbatja pastrë e mjedisit të territorit, është detyrë e përhershme në mënyrë që të sigurohet një mjedis shërbimi i kulturuar dhe cilësor.
- Vlerësohet puna e bërë nga drejtuesit e këtij subjekti.
- Riparimet e mjeteve të rënda dhe atyre të transportit kryhen në vende të vecanta duke marrë masa për uljen e ndikimit në mjedis dhe për të mos lejuar kontaminimin mjedisor me mbetje të lubrifikanteve.

❖ Rekomandime

- Të vazhdohet të kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen ambientet e punës.
- Të vazhdohet të kryhet rregullisht kontrolli i gjendjes teknike të agregateve teknologjike të mbrojtjes së mjedisit dhe mjeteve të transportit..
- Të merren masa dhe të kryhet rehabilitimi i mjedisit në rastet e ndonjë aksidenti.